



Gusht 2023

Tema: Mbështetje për realizimin e studimit “Shoqëria civile për qeverisjen e mirë: Një ndërhyrje kombëtare që synon forcimin e kapaciteteve, fuqizimin e partneriteteve, dhe ndërgjegjësimin e publikut”

KËRKESË

E nderuar Znj. Kryetare:

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN), me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” i zbatuar në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA), po realizon një studim cili ka si qëllim shqyrtimin e përfaqësimit të grave dhe burrave në politikë. Informacioni që do të grumbullohet përmes këtij studimi do të përdoret me qëllim forcimin e këshillave vendore. Përzgjedhja e këshillit tuaj është në vijimësi të studimeve të kryera në vitin 2016 (fill pas zbatimit të kuotës 50%) dhe në vitin 2018, për të kuptuar dhe hedhur dritë mbi ndryshimet e situatës në 5 vite.

Ne po u drejtojmë këtë kërkesë për të kërkuar bashkëpunimin tuaj gjatë grumbullimit të të dhënave. Koordinatorët e punës në terren planifikojnë të ndjekin dhe regjistrojnë takimet e këshillit bashkiak për disa muaj. Ky informacion do të grumbullohet me qëllim analizimin e diskutimeve që ndodhin në këshill, për shembull, shqetësimet e komunitetit që diskutohen gjatë takimeve, mënyra si trajtohen shqetësimet nga këshilltarët, si dhe propozimet që bëhen për të adresuar shqetësimet.

Të dhënat që do të grumbullohen nuk do të ndahen me palët e treta. Informacioni do të jetë konfidencial dhe vetëm drejtuesja e studimit dhe asistentët e saj do të kenë akses në informacion. Gjatë procesit, nuk do të grumbullohet asnjë informacion rreth këshilltarëve, si emri, mosha, apo partia politike. Në përfundim të studimit, ju do të merrni një kopje të publikimit ku do të njiheni me rezultatet.

Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim në lidhje me këtë studim, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Sinqerisht,

Dr. Marsela Dauti
Drejtuese e studimit
069 87 14 852
marsela.dauti@gmail.com

Ines Leskaj
Drejtoreshë Ekzekutive AWEN
069 2052 450
ines.leskaj@awenetwork.org

Geldona Metaj
Asistente e studimit
069 22 98 316
geldona@gmail.com